



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 508 prot.

VENDIM

Himare , me 01.02 2022

Nr. 4 datë 28/01/2022

PËR:

“PËR PËRJASHTIMIN NGA TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE TE DISA PROJEKTEVE TE INFRASTRUKTURES PUBLIKE KU BASHKIA HIMARE ESHTË BASHKE INVESTITOR DHE PERFITUES”

- o Bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar; LIGJ nr. 9632 date 30/10/2006 “Per sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; LIGJ Nr. 68/2017 27.04.2017 Për Financat e vetëqeverisjes vendore; Ligjit nr.107/2014 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar dhe akteve nenligjore te tij, neni 11, V.K.M-se nr.686, “Per miratimin e rregullores se Planifikimit te Territorit”; date 22.11.2017; Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Himare miratuar me Vendim te K.K.T-se nr.2 date 16.10.2017 te rishikuar , te zbardhur si dokument me date 19.03.2018 dhe rregulloreve perkatese te ketij Plani,

Si dhe ne:

- Marrëveshje Investimi (Rruga Gusmar-Kuc)
- Marrëveshje Investimit (Zona e plazhit Palasë-Drimadhë-Livadh)
- Marrëveshje e Huas (Programi i Ujësjellësave Ruralë IV)
- Marrëveshje Paraprake Investimit (RWSP IV- Lot 1, Lot 2, Lot 3)

Keshilli i Bashkise Himare ne mbledhjen e tij date; 28.01.2022, pasi mori ne shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT, ne perfundim :

VENDOSI:

PËR PËRJASHTIMIN NGA TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE TE DISA PROJEKTEVE TE INFRASTRUKTURES PUBLIKE KU BASHKIA HIMARE ESHTË BASHKE INVESTITOR DHE PERFITUES.

Projektet te cilat perjashtohen nga Taksa e Ndikimit ne Infrastruktura jane si me poshte:

1. Rikonstruksioni i rrugës Gusmar-Kuç (Programi i Rrugëve Lidhëse Rajonale dhe Lokale, donator Banka Botërore)
2. Ndërhyrje e integruar për përmirësimin e aksesit, shërbimeve dhe rikualifikimit urban në zonën e plazhit Palasë-Drimadhë-Livadh (Programi i Investimeve në Infrastrukturë, Qeveria Shqiptare)
3. Ndërtimi i linjës kryesore të transmetimit të ujësjellësit Himarë (Programi i Ujësjellësive Rurale IV, Lot 1, donator KfW)
4. Ndërtimi i linjës së transmetimit dhe rrejtit të brendshëm të furnizimit më ujë për Himarën, Himarë fshat, Livadh, Vuno, Pilur, Kudhës, Qeparo dhe Borsh si dhe ndërtimi i HEC 1 dhe HEC 2 për funksionimin e ujësjellësit Himarë. (Programi i Ujësjellësive Rurale IV, Lot 2, donator KfW)
5. Ndërtimi i KUZ për Himarë dhe Himarë fshat, ndërtimi i ITUN Himarë dhe largimi i ujërave të trajtuara në det për ITUN Himarë (Programi i Ujësjellësive Rurale IV, Lot 3, donator KfW)

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55-të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Vota pro 12 (dymbëdhjete)

Vota kundra 0 (zero)

Vota abstenim 0 (zero)

SEKRETARI

Elena Memushaj



KRYETARI

Dhimiter Kapaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. 286/2 prot.

Himarë , më 21 . 01 . 2022

RELACION

RELACION MBESHTETES PER PROJEKTVENDIMIN "PER PËRJASHTIMIN NGA TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE TE DISA PROJEKTEVE TE INFRASTRUKTURES PUBLIKE KU BASHKIA HIMARE ESHTË BASHKE INVESTITOR DHE PERFITUES".

(NE MBLEDHJEN E KESHILLIT BASHKIAK TE DATES 28.1.2022)

Në vijim të kuadrit të investimeve në infrastrukturë, Bashkia Himare së bashku me institucionet shtetërore perkatese dhe donatore të ndryshëm, vijojnë zhvillimin e programeve për realizimin e projekteve të infrastrukturës. Paraprakisht bashkia e Himares ka nënshkruar marrveshjet e investimit si më poshtë:

- Marrëveshje Investimi (Rruga Gusmar-Kuc)
- Marrëveshje Investimit (Zona e plazhit Palasë-Drimadhë-Livadh)
- Marrëveshje e Huas (Programi i Ujësjetësive Ruralë IV)
- Marrëveshje Paraprake Investimit (RWSP IV- Lot 1, Lot 2, Lot 3)

Në këto marrveshje Bashkia Himare është bashkeinvestitore në përqindje monetare si dhe kontribon me asetet e saja. Për të vijuar këtë procedurë investimi dhe realizimi, Bashkia Himare në një nga detyrat e saj të parashikuara në marrveshje është paisja e këtyre projekteve me Leje Nderimi Infrastrukturore të cilat në vijimin e procedurës së tyre kërkojnë llogaritjen e takses së ndikimit në infrastrukturë dhe likuidimin e saj. Kjo pjesë e procedurës sjell ngerc për Bashkinë Himare, Institucionet Shtetërore si dhe për më tepër tek Donatorët që janë financuesit kryesorë

te ketyre projekteve. Per te lehtesuar sa me shume keto procedura si dhe per te qene sa me koherente dhe mirenjohes ndaj donatoreve dhe institucionet shteterore kemi kerkuar me ate te Projektvendimit perkates qe keto projekte te perjashtohen nga taksa e Ndikimin ne Infrastruktura parashikuar ne VKB Nr. 54 date 25.11.2021 "Per paketen fiskale per vitin 2022", per projektet si me poshte:

1. Rikonstruksioni i rruges Gusmar-Kuc (Programi i Rrugëve Lidhëse Rajonale dhe Lokale, donator Banka Botërore)
2. Ndërhyrje e integruar për përmirësimin e aksesit, shërbimeve dhe rikualifikimit urban në zonën e plazhit Palasë-Drimadhë-Livadh (Programi i Investimeve në Infrastrukturë, Qeveria Shqiptare)
3. Ndërtimi i linjës kryesore të transmetimit të ujësjellësit Himarë (Programi i Ujësjellësive Rurale IV, Lot 1, donator KfW)
4. Ndërtimi i linjës së transmetimit dhe rrejtit të brendshëm të furnizimit më ujë për Himarën, Himarë fshat, Livadh, Vuno, Pilur, Kudhës, Qeparo dhe Borsh si dhe ndërtimi i HEC 1 dhe HEC 2 për funksionimin e ujësjellësit Himarë. (Programi i Ujësjellësive Rurale IV, Lot 2, donator KfW)
5. Ndërtimi i KUZ për Himarë dhe Himarë fshat, ndërtimi i ITUN Himarë dhe largimi i ujërave të trajtuara në det për ITUN Himarë (Programi i Ujësjellësive Rurale IV, Lot 3, donator KfW)

Ju falenderojme duke vlerësuar mirekuptimin tuaj per kete projektvendim!

KRYETARI I BASHKISË

JORGO GORO

